



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B-89
Datë: 01-09-2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01, mars 2019), nenit 32 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19, 9 shtator 2011), Udhëzimit administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017 të dt. 06.12.2017, nenit 50 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20 / 21 qershor 2016), nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 06.06.2020, nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 16.06.2020 dhe konkursit të datës 29.05.2020 të shpallur për ndarjen e bursave nxjerr këtë:

V E N D I M

Korrigjim i vendimit me nr. 01/B – 84 i dt. 25.08.2020 për përfitues të bursave për vitin akademik 2019/2020

1. Korrigjohet vendimi me nr. 01/B – 84 i dt. 25.08.2020, për përfitues të bursave për studentë në të dy nivelet e studimit Bachelor dhe Master për vitin akademik 2019/2020, pasi që gjatë hartimit janë lëshuar disa gabime teknike, si në vijim:

1.1. Në listën e Universitetit “Isa Boletini” të Mitrovicës, është bërë një gabim teknik tek mbiemri i studentëve: Në nr. rendor 22 duhet të jetë Blerina Istrefi, në nr. rendor 23 duhet të jetë Ensar Suma si dhe në nr. rendor 24 duhet të jetë Albulena Zahiti

1.2. Në listën e Universitetit „ Ukshin Hoti” në Prizren, është bërë një gabim teknik tek mbiemri i studentëve: Në nr. rendor 57 duhet të jetë Anesa Gjaha, në nr. rendor 66 duhet të jetë Medi na Saliji si dhe në nr. rendor 72 duhet të jetë Florentina Çollaku.

1.3. Në listën e dorëzuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” i Prishtinës, në nr. rendor 131 studentja Rinë Preniqi nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e konkursit, si dhe nr. rendor 587 dhe 588 është përsëritur dy herë emri i studentës Vlora Gjoka, kështu që në nr. rendor 587 mbetet Vlora Gjoka.

2. Numri i përgjithshëm i përfituesve të bursave për studentë në të dy nivelet e studimit Bachelor dhe Master për vitin akademik 2019/2020, pas korrigjimit është 1514.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe nevojës për korrigjimin e vendimit me nr. 01/B – 84 i dt. 25.08.2020 për përfitues të bursave për studentë në të dy nivelet e studimit Bachelor dhe Master për vitin akademik 2019/2020, pasi që gjatë hartimit janë lëshuar disa gabime teknike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. Zyrës së SP;
4. DAL/MASH;
5. Arkivit.

